



KOMITETI ORGANIZATOR

Nr. 126 Prot.,

Tiranë, më 07.10.2022

UDHËZIM

Nr. 1, datë 07.10.2022

“Mbi procesin e propozimit dhe të zgjedhjes për anëtarët e Komitetit Drejtues Kombëtar të Partisë Lirisë, në punimet e Konventës Kombëtare të thirrur në datën 29 tetor 2022.”

Në mbështetje të statutit të PL-së, neni 11.7; të Vendimit Nr. 5, datë 25.07.2022 të Komitetit Organizator si dhe të Vendimit Nr. 3, datë 07.10.2022 të Komitetit Organizator “Për thirrjen e Konventës Kombëtare”, e cila do të mbahet në 29 tetor 2022:

Vendosi

Mbajtjen e procesit zgjedhor për anëtarë të Komitetit Drejtues Kombëtar të Partisë së Lirisë në Konventën Kombëtare e cila do të mbahet në datën 29 tetor 2022;

Qëllimi politik: Organizimi i Partisë së Lirisë në nivel qendror; përgatitja e strukturave në fushatën së zgjedhjeve vendore për vitin 2023;

Për këtë:

- 1) Anëtarët e Komitetit Organizator dhe Delegatët e Konventës Kombëtare në çdo bashki përkatëse të cilët janë “grup pune”, propozojnë kandidatët për anëtarë të Komitetit Drejtues të Partisë së Lirisë.
- 2) Anëtarët e Komitetit Drejtues Kombëtar zgjidhen nga Konventa Kombëtare për një periudhë katër vjeçar nëpërmjet një procedure konkurimi me kandidatura alternative dhe me votim të fshehtë dhe elektronik.
- 3) Anëtarë të Komitetit Drejtues Kombëtar pa votim (*ex-officio*) janë: Kryetari i PL-së, Kryetari i Rinisë-së, Kryetarja e Gruas, deputetët e PL-së në Kuvendin e Shqipërisë, të zgjedhurit kryetarë të bashkive si dhe Kryetarët e PL-së të bashkive dhe të qarqeve.

- 4) Anëtari i Komitetit Drejtues Kombëtar, mund të jetë anëtari i partisë i cili plotëson kushtet e mëposhtme:
 - a) Të ketë veprimtari të spikatur politik në radhët e PL-së;
 - b) Të jetë individ me integritet moral dhe qytetar i spikatur dhe i vlerësuar në komunitet;
 - c) Të mos jetë i dënuar me Vendim Gjyqësor të formës së prerë me heqje lirie:
- 5) Afati i pranimit të kandidaturave për anëtarë të Komitetit Drejtues Kombëtar do të jetë nga data 14 – 24 tetor 2022.
- 6) Miratimi i propozimeve të kandidaturave për anëtarë të Komitetit Drejtues Kombëtar do të kryhet nga Komiteti Organizator.
- 7) Lista e kandidatëve për anëtarë të Komitetit Drejtues Kombëtar do të jetë duke respektuar parimin e barazisë gjinore; jo më pak se 50% të forumit të gruas dhe jo më pak se 30% të forumit të rinisë.
- 8) Kandidatët e Komitetit Drejtues Kombëtar që do të shpallen për votim do të listohen sipas sipas rendit alfabetik.
- 9) Në listën e votimit të kandidatëve do të vendosen qartë gjeneralitetet:
 - a) Emër, mbiemër
 - b) Bashkia nga ku kandidon
 - c) Forumi që e propozon (PL, Gruaja, Rinia)
- 10) Përfaqësimi në Komitetin Drejtues Kombëtar do të jetë duke respektuar parimin e barazisë gjinore; jo më pak se 50% të forumit të gruas dhe jo më pak se 30% të forumit rinor të Partisë së Lirisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Zv/ Kryetar i Komitetit Organizator

AGIM NESHO

